



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.1083/2021

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), i përbërë nga gjyqtaret: Milena Đerić kryesues, Rrustem Thaqi dhe Faton Ademi anëtar, duke vendosur përkitazi me apelin e kandidatit për anëtarë të Kuvendit Komunal në Komunën e Skenderajt Azem Gashi nga Subjekti Politik Lista e Pavarur Bekim Jashari, me seli në Komunën e Skenderajt, paraqitur kundër vendimit me numër 2948-2021 i datës 03.11.2021, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për Shpalljen e Rezultateve Përfundimtare për Zgjedhjet Lokale 2021, për Kuvendin Komunal, në seancën e panelit të mbajtur më datë 07.11.2021, mori këtë:

V E N D I M

Refuzohet i pabazuar apeli Anr.1083/2021 i datës 04.11.2021, paraqitur nga kandidatit për anëtarë të Kuvendit Komunal në Komunën e Skenderajt Azem Gashi nga Subjekti Politik Lista e Pavarur Bekim Jashari, me seli në Komunën e Skenderajt me të cilën ka kërkuar rinumërimin e fletëvotimeve në vendvotimet 2101B/01R, 2101B/02R, 2102B/01R, 2102B/02R, 2125B/01R, 2125B/02D, 2111B/01R, 2111B/02D, 2101X/03R, 2101X/04R, 2128B/01R, 2117B/01R, 2117B/02D, 2121B/02D, 2108B/03R, 2130B/01R, 2124B/02D, 2132/01R, 2105B/01R, 2105B/02R, 2105B/03R, 2115B/01R, 2115B/02R dhe 2115B/03D në Skenderajt.

A r s y e t i m

PZAP-i, ka pranuar një apel me datën 04.11.2021 nga e kandidati për anëtarë të Kuvendit Komunal në Komunën e Skenderajt Azem Gashi nga Subjekti Politik Lista e Pavarur Bekim Jashari, me seli në Komunën e Skenderajt me të cilën ka kërkuar rinumërimin e fletëvotimeve në vendvotimet 2101B/01R, 2101B/02R, 2102B/01R, 2102B/02R, 2125B/01R, 2125B/02D, 2111B/01R, 2111B/02D, 2101X/03R, 2101X/04R, 2128B/01R, 2117B/01R, 2117B/02D, 2121B/02D, 2108B/03R, 2130B/01R, 2124B/02D, 2132/01R, 2105B/01R, 2105B/02R, 2105B/03R, 2115B/01R, 2115B/02R dhe 2115B/03D, me pretendimin se në këto vendvotimet e kanë votuar shumë familjarë mirëpo votat e tij janë deformuar nga komisionerët në Formularët e Përputhjes së të Dhënave dhe Rezultateve.

Si dëshmi ka bashkangjitur letërnjoftimet e dy personave.

PZAP-i, pas shqyrtimit të apelit, vlerësimit të pretendimeve ankimore, dhe në kuptim të nenit 105 paragrafi 1, dhe nenit 117 paragrafët 2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

Apeli është i pa bazuar

Nga shkresat e lëndës rezulton se kandidati për anëtarë të Kuvendit Komunal në Komunën e Skenderajt Azem Gashi nga Subjekti Politik Lista e Pavarur Bekim Jashari, me seli në Komunën e Skenderajt ka parashtruar apel me të cilën ka kërkuar rinumërimin e fletëvotimeve në vendvotimet lartcekura.

Paneli, vlerëson se parashtruesi i apelit në mbështetje të pretendimeve të tij, nuk ka ofruar dëshmi të qarta dhe bindëse lidhur me shkeljet e supozuara për mospërputhje të rezultateve, edhe pse në kuptim të nenit 117 paragrafi 3 të LZP-së, barra e të provuarit bie mbi ankuesin, në rastin konkret paneli, nuk mundi të konstatoj se ka pasur manipulime gjatë numërimit të votave për kandidat të këtij subjekti politik, ashtu siç pretendon ankuesi, për faktin se thëniet e tij nuk mbështetën në asnjë provë konkrete por janë supozime sepse pritjet e ankuesit për të marrë më shumë vota automatikisht nuk nënkupton se ka mospërputhje të rezultatit si dhe llogaritja matematikore nga ana e ankuesit nuk argumenton shkeljet e pretenduara në apel.

Andaj, nisur nga arsyet e theksuara më lartë e në kuptim të neneve 115 paragrafi 1, 117 dhe 118 paragrafi 1 të LZP-së, paneli, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Anr.1083/2021 më datën 07.11.2021**

Kryesuesi i Panelit

Milena Dardaj



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 1 të LZP-së në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimimit të këtij vendimi.